

V E N D I M
Nr. 370, datë 23.7.2002

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, QË DËRGOHEN PËR STUDIME E SPECIALIZIM BRENDA DHE
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që dërgohen për studime dhe specializim në institucionet arsimore brenda vendit përfitojnë pagë, për periudhat respektive, në masën si më poshtë vijon:

a) deri në 6 (gjashtë) muaj, pa shkëputje nga puna, pagën e plotë për funksion (gradë);
b) më shumë se 6 (gjashtë) muaj, me shkëputje nga puna, pagën për funksion (gradë) që ka patur në çastin e shkëputjes nga detyra, duke zbritur shtesën për vështirësi.

2. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, që dërgohen për studime dhe specializim në institucione arsimore jashtë vendit përfitojnë pagë, për periudhat respektive, në masën si më poshtë vijon:

a) deri në 6 (gjashtë) muaj, pagën e plotë për funksion (gradë);
b) mbi 6 (gjashtë) muaj, por deri në 2 (dy) vjet, pagën për funksion (gradë) që ka pasur në çastin e shkëputjes nga detyra, duke zbritur shtesën për vështirësi.

3. Ushtarakëve që përfshihen në shkronjën "b" të pikës 2 u jepet paradhënie në masën 3 (tre) paga mujore.

4. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Kur ushtaraku aktiv nuk pranon të kthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në detyrën e re që emërohet, ai detyrohet t'i dëmshpërblejë institucionit shpenzimet e bëra për studimin apo specializimin e tij.

6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.295, datë 18.7.1964 i Këshillit të Ministrave "Mbi dhënien e shpërblimit familjeve të punonjësve dhe ushtarakëve aktivë, që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime", ndryshuar me vendimin nr.55, datë 8.4.1970 të Këshillit të Ministrave, nuk zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko